



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAÇ/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>5379</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>40</u>		
Data/Datum/Date <u>6 / 3 / 25</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Procesverbali i takimit publik konsultativ
për fatin e hotel “Park Plaza” në Rahovec

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bën njoftimin për:

TAKIM PUBLIK KONSULTATIV ME QYTETARË

Me 18.02.2025 është publikuar njoftimi për mbajtjen e takimit publik konsultativ me qytetarë për të vendosur për fatin e hotel “Park Plaza” në Rahovec, të cilit i është shkëputur kontrata për veprim. Njoftimi është publikuar në webfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

1. Publikimi në webfaqe: <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/NJOFTIM-PER-TAKIM-KONSULTATIV-ME-QYTETARE.pdf>
2. Publikimi facebook: <https://www.facebook.com/share/p/19Upf4Yr89/?mibextid=wwXlfr>
3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewMeeting.php?MeetingID=339>

TAKIMI KONSULTATIV

Më datë: **25.02.2025** mbahet takimi konsultativ në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, qytetarë, dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën: <https://rahovec.rks-gov.net/news/mbahet-takimi-konsultativ-per-hotel-park-plaza-ne-rahovec/>

Takimi konsultativ filloi në orën 10:30.

Takimin e shpalli të hapur **Blerta Gashi**, *zyrtare për Informim*; Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Zyrën për Informim ka organizuar takimin publik konsultativ me qytetarë. Në mbledhjen e mbajtur më datë 22.11.2024, ka marrë vendim për shfuqizimin e rekomandimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, respektivisht **hotel “Park Plaza”** në Rahovec. Pas vendimit të Kuvendit, kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi, ka marrë vendim për shkëputje të kontratës me nr. prot. 2099, të datës 24.5.2013, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe aneks-kontrata me Nr. Prot. 02/150, e datës 10.2.2023, mbi kontratën bazë me Nr. Prot. 2099, të datës 24.5.2013.

Andaj, për të vendosur bashkërisht për fatin e hotel “Park Plaza”, të cilit i është shkëputur kontrata për veprim, kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi, në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, kanë organizuar takimin publik konsultativ me qytetarë.

Tani ftoj kryetarin e komunës, z.Smajl Latifin që në pika të shkurta të paraqes para jush rrjedhen e procesit dhe më pas keni të drejtën të jepni mendim dhe ide ju si pjesë e rëndësishme e këtij takimi konsultativ.

Smajl Latifi, *kryetar i komunës*: Përshëndetje për pjesëmarrësit, sipas ligjit parashihet konsultim publik me grupe të interesit, qytetarë në pozicione çfarë jemi në raport me një pronë të komunës dhe një objekt i cili është pa shfrytëzues, sepse vendimi i Kuvendit të Komunës i ka dhënë mundësi kryetarit, pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL që të shkoj drejtë shkëputjes së kontratës. Kjo do të thotë që hoteli “Park Plaza” nuk është më në shfrytëzim, vazhdon të mbetet pronar komuna

e Rahovecit. Sipërfaqet në të cilat ka përfshirë, prona që i është dhënë në shfrytëzim për 15 vite, nga 26.03.2013 deri me 10.02.2023 dhe ka vazhdu dhënia në shfrytëzim deri në vitin 2028, ka qenë afati i përmbylljes së kontratës midis komunës së Rahovecit dhe shfrytëzuesit, por pas zhvillimeve të cilat ju i dini në sheshin qendror, ai objekt vazhdon të mbetet një pozicion i cili ose është i tepruar si i tillë, ose duhet të ndërmerren hapa të tjer në pajtim me ligjin, të jetë funksional si objekt në përputhshmëri me standardet e sheshit qendror. Ajo është pronë e komunës dhe ka një situatë të paqartë me Agjencionin e Kosovës për Privatizim, lënda është në proces por nuk ka qenë aktive, ata kanë një padi ndaj komunës së Rahovecit, jo tash por e kanë kahere, për arsye se kanë konsideruar që komuna jonë nuk ka të drejtë të marrë qira prej hotel Park Plaza, sipas tyre është objekt i AKP-së. Ne kemi vazhduar me marrjen e qerasë për këtë objekt dhe për hapësirën.

Ne duam ta ruajmë statusin e pronës dhe besojmë që edhe AKP-ja nuk do të paraqesë problem rreth të ardhmes së objektit, së paku në këtë fazë. Ka ide të ndryshme të cilat i kemi dëgjuar edhe ju e ja vlen të diskutohen.

Ne nuk kemi para për të investuar vet dhe parashihet që sektori publik të investojë në një hotel i cili do të ishte me standarde tjera, në përputhje me kërkesat, nevojat, trendin dhe specifikat që i ka Rahoveci. Në cilësinë e kryetarit të komunës, kisha ftu operator privat të komunës së Rahovecit, me pa interesimin e tyre për veprime të mëtejshme.

Tani fjala është e juaja.

Vllaznim Canziba: Përshëndetje, jam përfaqësues i blegtorëve të komunës së Rahovecit. Dua të paraqesë dy ide, por fillimisht dua ta përshëndes kryetarin me stafin e tij dhe pjesëmarrësit në këtë takim. Ky takim është shumë i rëndësishëm sepse bëhet fjalë për një projekt madhështor, ju është dhënë mundësia qytetarëve të kenë një shesh të bukur, një hapësirë në të cilën, qyteti i Rahovecit ka qenë i ngulfatur dhe tani po merr një pamje tjetër. Unë i kam dy ide, ju veç se jeni të njoftuar me qendrimet e mijë, njëra është që atje të bartet objekti i komunës, sepse drejtoritë janë të shpërndara, konsiderojë që pozicioni është më i qashtë dhe më i lehtë për të gjithë qytetarët. Opsioni i dytë është rrënim i hotelit dhe të zgjerohet sheshi, sepse e kemi një shije të hidhur me Kosovën, vendosin pengesa në rrugë, nuk do të jetë i njëjti kryetar çdoherë që e mirëmban atë projekt, do të vijin gjenerata të reja, operatori privat e shfrytëzon parkingun i cili është ndertu me para tona.

Pas shpalljes së pavarësisë, ky është lajmi i dytë më i mirë për mua si qytetar i komunës së Rahovecit, sepse do të lirohet një hapësirë, aty mund të ketë salla të mjaftueshme për kuvendin komunal, në katin përdhësë mund të bëhet një restorant, të shfrytëzohen disa zyre si; shoqata e vertarëve, zyre për turizëm, objekti është më afër qytetarëve dhe pamje më të mirë. Faleminderit për mundësinë e ljalës.

Shpetim Mustafa: Përshëndetje për të gjithë, në cilësinë e qytetarit po jap këtë mendim, hoteli duhet të mbetet ashtu siç është sepse rinovimi ka ndodhë pas lufte, qyteti i Rahovecit nuk ka ndonjë hotel tjetër përpos tij. Duhet ti jepet në shfrytëzim një biznesi i cili ka kapacitet me standarde evropiane. Ne e kemi hardh festin, gjatë atyre ditëve vizitorët nuk kanë mundësi të akomodohen në Rahovec në munges të hoteleve.

Naim Kafexhiu: Përshëndetje për të pranishmit. Aty duhet të qëndroj hoteli sepse në çdo qytet duhet të ketë një hotel, mirëpo struktura e tij është e papërshtatshme dhe nuk i plotëson standardet as minimale për një hotel në të cilin sheshi po ndërtohet. Ne llogaritemi si një regjion i vjetër, mirëpo në shumicën e rasteve, me dhe pa vetëdije i kemi humb vetit e qytetit që i ka, janë ndërtu disa bujtina por duhet të jetë edhe përcjells për vizitën e bujtinave, që të ketë shenjë të mirë, hoteli duhet të ndërtohet me një arkitekturë tradicionale, a do të jetë investim publiko-privat apo vetëm privat, rëndësi të plotësoj kriteret.

Edon Cana: Përshëndetje! Unë mendoj që kjo tradit e shkatërrimit të trashëgimisë urbanistike apo akriturore të Rahovecit duhet me u ndal dhe hoteli si objekt duhet të qëndroj ashtu. Hoteli i ka të gjitha kapacitetet infrastrukurore për rinovim, me rëndësi është që si koncept me qenë në përputhje, kompania e cila e merr hotelin duhet të jetë kompani e cila ka tradit hoteliere ndërkombëtare, nëse jo atëhere duhet të përjashtohet ky koncept që duhet patjetër nga komuna e Rahovecit të investoj, rëndësi të ketë profesionalizëm të mjaftueshëm, unë i kam disa miq që i njoh të cilët në Prishtinë kanë marrë franqiza të ndryshme dhe dallojnë nga hotelet të cilat janë të menaxhuara nga individ sepse e kanë një sistem tjetër dhe standardet duhet të jenë në përputhje me këtë proces. Objekti si struktur ka devijuar me renovimin, është shëndërru nga një objekt i cili e ka pas një arkitekturë identifikuese, u shëndërru në një fasad të një tipi evropiano lindor të deformuar. Prandaj rikthimi në fasadën origjinale dhe investimi i duhur në këtë drejtim është në përputhje me trashëgiminë arkitekturore të Rahovecit, pajtohem me mendimin e Naimit të vendosën disa elemente që janë identifikuese për komunën tonë. Megjithatë, ne do të presim nga

komuna ide, por është jetike që ky investim të jetë në përputhje me interesin e përgjithshëm të natyrës së komunës sonë e cila do të jetë në pritje të qytetarëve që vijn jo vetëm për hardh fest për një turizëm të gjithëjetuar, pra gjithë vitin të kemi turista dhe njerzit të jenë në gjendje ta vizitojnë Rahovecin. Vendimet që do të merren duhet të jen në përputhje me planin e përgjithshëm të sheshit dhe të mos del nga koncepti i sheshit.

Shaip Shala: Uroj që të lajmërohet ndonjë operator, çoftë me rinovu ose të ndërtohet hotel i ri, Rahovecit i duhet hoteli sepse është vend turistik dhe turistat po detyrohen të akomodohen në hotele të Gjakoves ose Prizrenit.

Dritan Tara: Përshëndetje! Debati shumë i qelluar dhe ja vlen të diskutohet, sot do të ishte më e logjikshme të shohim më shumë arkitekt dhe inxhinier të komunës, ky është vendi ku duhet të shpalosin ide. Po dëgjoj mendime të ndryshme, nëse shikojmë përreth çdo qytet ka nga një hotel të mirë brenda qytetit, lehtë është të rrënohet diçka, por vështirë të ndërtohet. Pse të zhdukim një biznes i cili mund të jetë taksapagues i rregullt i cili bën punësime, si nga ai vet hoteleri si nga ai sezonal dhe më teper, aty kemi edhe dyqane përreth që mund të jen profitabile për qytetarë. A do të duket sheshi më bukur me apo pa hotel, vetem se hoteli duhet te ketë një pamje të përshtatshme, unë mendoj që duhet të ketë hotel, i cili më pas duhet të ketë kritere dhe operatori të jetë i qëlluar në investim.

Smajl Latifi, kryetar i komunës: Veç edhe një informatë, Plani i ri Zhvillimor Komunal ka standarde tjera të ndërtimit, poashtu hoteli se si do të duhet të duket i rinovuar i shfrytlëzuesit në disa pamje (kopje fizike), janë të parapara investime rreth 2 milion e 600 mij euro, prandaj kemi qenë të detyruar të marrim vendime, madje cilësohet si vones e jona, por kemi shpresuar në mirëkuptime. Dikure ky hotel ka qenë magnet për shumë njerëz, viteve të fundit ky hotel nuk i ka shërby askujt. Njëra pamje nga jashtë është e bukur, brenda nuk është mirë dhe kemi qenë të detyrur të marrim hapa institucional ligjor, në mënyrë që bëjm zgjidhje. Ne nuk e marrim përsipër rrënimin sepse ka kosto financiare. Operatori që e merr mund te riorganizoj me komponentet që përmendi Naimi dhe Edoni, ai duhet të parasheh a duhet të rrënohet apo jo. Ne do të formojmë një komision për gjendjen momentale të objektit. Pa hotel nuk duhet të jetë sheshi sepse është sipërfaqe e madhe, por duhet një hotel që është funksional. Uroj që të ketë interesim dhe njerëz të guximshëm sepse aty parashihet me pas zhvillime, megjithatë mund të rritet kapaciteti i hotelit.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Jo rastësisht prita që të marrin fjalën disa qytetarë, unë kohë më parë në scancen e nëntorit e kam dhënë një mendim që paljetër Rahoveci duhet të ketë hotelin në atë pjesë, por në cilësinë e arkitektes nuk më lejohet të flas për rrënimin e trashëgimisë, sepse objektet e vjetra duhet të ruhen e ne si profesionista duhet me qenë idhtarë në ruajtjen e trashëgimisë, por në këtë rast e kam një mendim tjetër, ai objekt me gjendjen momentale nuk e përfaqëson ndonjë stil të arkitektures ose ndonjë trashëgimi të qytetit të Rahovecit. Vite më parë kur është bërë rinovimi i tij, ai e ka humb identitetin apo memorien kolektive që ka mujt me përfaqësu në Rahovec, për atë arsye i qëndroj mendimit që objekti duhet të rrenohet dhe të ndërtohet një hotel me standarde evropiane, por gjithmonë me investim privat dhe shfrytëzimi të jetë afatgjatë ndërsa kushtet dhe kriteret të caktohen nga komuna. Për shkak të rëndësisë së vendit duhet të jetë diçka më madhështore, standardet e ndërtimit duhet të jenë të larta dhe shpresoj që tu jepet rëndësi si në analizën e fizibilitetit dhe të arkitekturës, gjithmonë kur është investim privat rëndësia e projektit është më e madhe. Falënderit.

Drilon Mustafa: Përshëndetje për të gjithë, ju falënderoj që keni marrë pjesë në këtë aktivitet të organizuar nga komuna. Si arkitekt konsideroj që është prej dy vendimeve më të rëndësishme në komunën e Rahovecit pas largimit të stadiumit dhe ndërtimin e sheshit. Sheshi na implikon disa gjëra duke analizuar objektin në fjalë, i cili çdo objekt nëse sot projektojmë ne, sigurisht pamjen kryesore ja orientojmë nga sheshi, ky objekt e ka shpinën e kthyer nga sheshi dhe ky objekt duhet të rrenohet dhe analiza duhet të bëhet vetëm lokacionit. Unë e kam dhënë mendimin tim edhe ne PZHK që atje duhet të vendosen institucionet, nëse komuna nuk e sheh të arsyeshme, sigurisht që është një investim i lart por me kompenzimin e kësaj pjese që jemi këtu me investim të ndryshëm, mendj që atje duhet të vendosen institucionet për shumë arsye, si lokacion i takon institucioneve komunale, nëse kjo nuk ndodhë për arsye financiare, atëherë opsioni i dytë është që komuna të njetin gabim nuk duhet ta bëjë dy herë, aty hoteli ka qenë dhe nuk ka funksionu, hoteli është diçka përfituese, nëse është diçka përfituese komuna i kish pas 50 hotele. Në komunën tonë nuk është i zhvilluar shumë turizmi që të ndërtohet mega hotel, edhe nëse jepen në kosucion për qytetarë duhet të bëjë një ndërtesë e cila sigurisht do të ketë edhe pjesë të hotelit por të jetë edhe banim, në të kundërtën mendoj që ka me dështu, nuk ka me pas një operator i cili e merr atë parcelë vetëm për hotel sepse del një hotel shumë i madh, ne mund të ndërtojmë një hotel si Grandi, krahasimi i komunës së Rahovecit me komunën e Prishtinës është një me njëzet dhe nuk do të funksionoj. Ne mund të bëjmë një objekt të kombinuar, katër retazhe mund të jetë hotel, pjesa tjetër banim, të tilla raste

kemi në Fushë Kosovë, janë 5-6 objekte ku dy katet e fundit janë hotel, pjesa tjetër shfrytëzohet për banim. Ai vend nuk duhet të hudhet dhe të jepet veç për hotel. Unë jam kundër që të ndërtohet vetem hotel!

Sylejman Daka, inxhinier i ndërtimitarisë: Përshëndetje, unë e ndaj mendimin e të tjerëve që në atë vend duhet të jetë një hotel, nuk domethënë të përcaktojmë tash madhësinë e hotelit, por është me rëndësi që koncepti i hotelit të përshtatet me konceptin e sheshit dhe me konceptin e arkitekturës së qytetit të Rahovecit, e pastaj vijn karakteristikat tjera se çka duhet të përmbaj ose me sa yje duhet të jetë ai hotel, cilat standarde duhet ti plotësoj hoteli, pastaj ato përcaktohen me kritere të cilat duhet të shpallen me rast të shpalljes së tenderit, me ankand ose me formën projekt i mbyllur, domethënë projektim dhe ndërtim që kompanitë të ofertojnë edhe me projekt edhe me ndërtim e pastaj vjen kohëzgjatja e dhënies në shfrytëzim e asaj hapësire. A duhet të rinovohet hoteli ekzistues apo të ndërtohet hotel i ri janë çështje tjera, ndoshta mundet edhe ky hotel me u rinovu me arkitekturë që i përshtatet trevës sonë. Komuna jonë po shkon drejtë zhvillimit të agroturizmit dhe automatikisht paraqitet nevoja për hotele.

Sali Metkamberi: Çështje e hoteli është e patrajtuar nga plani i vendosjes së sheshit dhe kemi ardh në një situat që duhet patjetër të ndryshohet, si qasj ndaj hotelit si vendosja e objekteve përreth nuk kanë koordinim njëra me tjetrën, kështu si ka mbet duhet patjetër të ndryshohet. Çështja e ndryshimit varet nga komuna, kryesisht nga kryetari që do të bëhet me konsecion sigurtisht se kemi edhe ne diçka përfitim, nese i jipet për 99 vjet ajo konsiderohet e tij të veproj si të dojë. Rinovimi, rrënimi apo zgjerimit ajo është me kërkesat tona se çfarë kategorie dëshirojmë të kemi një hotel, nese kemi mundësi të kontrollojmë e jo si deri më sot që ka qenë pa menaxhim. Si arkitekturë është më shumë çështje shijesh, por të jetë funksionale.

Naser Dula: Përshëndetje për të gjithë! Po më vjen mirë që shumica janë që hoteli të jetë në qytet, normalisht nuk ka qytet pa hotel, pa teater. Hoteli që është momentalisht mund të them që është më i keq në Kosovë. Hotelet sot kanë salla të konferencave dhe me shumë hapësirë, rinovimi kushton më shumë se ndërtimi i ri, mendimi im është që të rrënohet objekti dhe të bëhet plan i ri modern në kuadër të asaj që ka sheshi dhe kemi nevoj të shohim risi e jo diçka që kemi pa 50 vite, gjithmonë në monitorimin e komunës së Rahovecit.

Mustaf Korenica: Përshëndetje kryetar dhe gjithë ju të pranishëm. Po ndërhyj te parafolësi z.Kamberi kur tha që bizneset private mund të manipulojnë, nuk është e vërtet kjo! Kryetar, unë prita që ju të shpalosni idetë e juaja në lidhje me hotelin, për këtë arsye edhe morra pjesë në këtë takim. Secili prej nesh kemi ide, nuk do të thotë të pajtohemi të gjithë një propozimi a mendimi, për këtë arsye është edhe takimi për diskutim në lidhje me hotelin. Për mua hoteli ka qenë i mirëseardhur për kohën e vet, ju ka shërby qytetarëve aq sa ka pas mundësi operatori i cili e ka pas në shfrytëzim, tani jemi në rrethana tjera, punimet në shesh po vazhdojnë e shumë mirë që po bëhet, ndoshta ka qenë më mirë që hoteli si objekt të ishte në kuadër të projektimit të sheshit. Ka ardh momenti me mendu ndryshe, nuk pajtohem që hoteli të funksionoj si hotel, por ndoshta është mirë të mendohet ti ndërrohet destinimi i atij objekti për ndonjë qëllim tjetër të caktuar dhe në takimin tjetër e shpalosi si ide.

Smajl Latifi, kryetar i komunës: Po dominon ideja që hoteli duhet të ruhet, si i riorganizuar apo i ndërtuar, pati edhe ide të rrënohet dhe unë isha i qart që ne nuk e shohim të arsyshme, në një proces të mëvonshëm mund ta parasheh operatori në bashkëpunim me komunën. Hoteli nuk mund ti jepet më ndonjë subjekti ekonomik i cili nuk ka dëshmi që merret me hotelcri sepse nuk i kontribuojmë vetes e as qytetarëve e as shfrytëzuesit nëse ne e përsërisim si eksperiment. Tash hoteli nuk paraqet ndonjë trashëgimi sepse e ka humb me rinovim. Ne nuk mund të ndërtojmë një hotel i cili nuk korrespondon me sheshin. U diskutu edhe ideja e vendosjes së institucioneve komunale, shembulli i Klínes kur u ndertu objekti me konsesion, ide e mirë por e largët. U diskutu edhe çështje e ruajtjes së statusit të pronës dhe përfitimet e komunës, ne nuk mundemi me ia falë askujt, kjo periudha 99 vjet është mundësi me pas plane më afatgjatë, sepse për 15 vjet plot investitor përtojnë pavarësisht sigurisë që mundësh me ja ofru. U diskutu edhe çështje e ndërrimit të destinacionit, por është vështirë me mendu qytetin pa hotel. Në muajin mars po përgatitemi të fillojmë bazën për hapat e parë dhe në muajin prill të del në kuvend për ndërtimin e mekanizmit të shprehjes së interesit të komunës. Komuna i ka në dorë kriteret e standardeve, cilësisë sepse ekziston mundësia të bëhet P+6, objekti ekzistues është më i ulët, ekipet tona vendosin a me qenë vetëm hotel apo edhe dikë tjetër. I ftoj inxhinierat e komunës, arkitektat e komunës që të punojnë për një detyrë projektuese në bashkëpunim me drejtorin e Urbanizmit si përgjegjës, drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe drejtorin e Gjeodezisë. Ju falenderoj të gjithëve për kontributin!

Konsultimi publik përfundoi në orën: 11:53h

FOTOGRAFITË DHE LISTA E NËNSHKRIMEVE







Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në takim konsultativ për fatin e hotel "Park Plaza"

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1.	ALI	HOJHA	RAHOVE	[Signature]
2.	Hamid	RAMA	RAHOVE	[Signature]
3.	Mustafa	KORENIJA	RAHOVE	[Signature]
4.	ALBER	SEVINI	RAHOVE	[Signature]
5.	ARMIR	KRASNIQI	RAHOVE	[Signature]
6.	ANNI	MORINA	RAHOVE	[Signature]
7.	NAIM	KAFENIJA	RAHOVE	[Signature]
8.	Andri	KONAR	RAHOVE	[Signature]
9.	Sylejman	DUKA	RAHOVE	[Signature]
10.	Skender	HERIJA	RAHOVE	[Signature]
11.	Muhamet	CONIJA	RAHOVE	[Signature]
12.	FIJAN	HOJI	Kosë e Hotit	[Signature]
13.	SHAFI	MUSTAFA	RAHOVE	[Signature]
14.	Feride	KASAPI-JSA	RAHOVE	[Signature]
15.	Shaj	HOJHA	RAHOVE	[Signature]
16.	Arif	DUKA	RAHOVE	[Signature]
17.	Almetina	JABA	RAHOVE	[Signature]
18.	BEIN	KRASNIQI	RAHOVE	[Signature]
19.	MERISA	SHARIJA	RAHOVE	[Signature]
20.				

Më 25.02.2025



Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në takim konsultativ për fatin e hotel "Park Plaza"

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1.	EMIN	SHENU	RAHOVE	[Signature]
2.	EDON	ORINA	RAHOVE	[Signature]
3.	DRITAN	TABA	RAHOVE	[Signature]
4.	ALBAN	GASHI	KOSJË E HADHC	[Signature]
5.	SEAD	RABA	OSCE MT RH	[Signature]
6.	Erion	DINA	RAHOVE	[Signature]
7.	VISET	SOKOLI	RAHOVE	[Signature]
8.	ASTRI	MULLIBARI	RAHOVE	[Signature]
9.	SELIM	METKAHBERI	RAHOVE	[Signature]
10.	TEKI	MUSTAFA	RAHOVE	[Signature]
11.	SHAJP	SHATA	RAHOVE	[Signature]
12.	FERIZ	THAQI	ÇIFLLAK	[Signature]
13.	SOROL	THAQI	ÇIFLLAK	[Signature]
14.	ILIR	UKAJ	RAHOVE	[Signature]
15.	MIRAN	DILA	RAHOVE	[Signature]
16.	VIJAN	KRASNIQI	HOC E VOJEL	[Signature]
17.	VALDIR	GASHI	SERRIA	[Signature]
18.	BEJAN	MUSTAFIJA	GUR I KUR	[Signature]
19.	MIRAN	CONIJA	RAHOVE	[Signature]
20.				

Më 25.02.2025

Zyra për Informim

